



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal
Komuna e Kamenicë
Datë: 15.07.2026

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHËRBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. <u>01</u>	Nr./Br./No. <u>19665</u>
Nr.faq. Br. Str. No. Pg.	Data Datum Date
<u>15/07/26</u>	
KAMENICE - KAMENICA	

Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesja e Kuvendit me datë: 15.07.2026,

THËRRET

Mbledhjen e VII, të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet ditën **e enjte**, më datë: **23.07.2026**, duke filluar në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhjen propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VI, e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxheta i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Prill – 30 Qershor (TM2);
3. Propozim vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Asfaltimi i rrugës ‘Shyt Vaku’ – Degëzim”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit me Znj.Shqiponjë Pira;
4. Propozim vendim për caktimin e kompensimit për anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM “Higjena” dhe në NPL “Dardana” SH.A në Kamenicë;
5. Propozim vendim për pëlqim paraprak dhe inicim të procedurës së shprehjes së interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale;
6. Propozim vendim për lejimin e mjeteve financiare për Kryqin e Kuq të Kosovës – Dega Kamenicë;
7. Të ndryshme.

Arbnore BEOTRAJFERA

Kryesuese e Kuvendit të Kamenicës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më: 22.06.2026

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës dhe filloj ora 10:05. Në mbledhje përveç anëtarëve të pranishëm ishin, shërbimi profesional i kuvendit, zyrtar të tjerë komunal, përfaqësues nga OSCE. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesja e Komitetit për Politikë dhe Financa, Arbnore Beqiraj Fera e cila për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e V-të, e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kamenicës 2027-2029.
3. Të ndryshme.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal Të nderuar Anëtar dhe Anëtare të KPF-së.

Mirë se po takohemi në mbledhjen e VI-të, të rregullt të këtij viti. Konstatoj se kemi korum të mjaftueshëm për ta mbajtur këtë mbledhje, Rendin e ditës dhe materialin e keni pranuar me kohë, A keni propozime për rend dite?

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, pasi që nuk ka propozime e hedhim në votim Rendin e Ditës

Kush është për miratimin e rendit të ditës ?

Për, 4

Kundër dhe Abstenim nuk ka

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar për Politikë dhe Financa

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal - jemi në pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së, a keni vërejtje apo diskutime rreth kësaj pike ?

Kush është për miratimin e kësaj pike?

Për: 5

Kundër: 0

Abstenime: 0

2. Propozim vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kamenicës 2027-2029

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika e dytë është Propozim vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Kamenicës 2027-2029, fjalën për këtë pikë ja japim

Selami Zylfiu – Zyrtar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa Përshëndetje Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Komuna e Kamenicës ka përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029, nuk dua të ju marë shumë kohë vetëm një prezantim të shkurtë si njoftim se nga është orientuar Komuna e Kamenicës. Kjo kornizë është përgatitur sipas Kornizës Afatmesme 01 / 2027 dhe në bazë të formulës shtetërore në bazë të regjistrimit të fundit të popullsisë Komuna e Kamenicës ka 22.868 banorë, duke iu referuar formulës shtetërore e cika ka kufizime të caktuara rezulton se kemi një zvogëlim të buxhetit të komunës për 275.895 euro ose 1.77 % më i vogël se vitin e kaluar. Si rezultat kemi një zvogëlim të Grandit të Arsimit, po i shpalos Grandit veç e veç shuma totale e buxhetit të planifikuar për vitin 2027 është 15,329,208.00 euro të cilat:

Grandi Qeveritar është 8,769,138.00 euro ose 57.21 % e Buxhetit të Komunës.

Grandi specifik i Arsimit është 3,438,157.00 euro ose 22.43 %

Grandi i Shëndetësisë është 1,743,697.00 euro ose 11.37% dhe

Shërbimet Rezidenciale i cili llogaritet si grand i mbrojtur është 220,000.00 euro ose 1.44%

Të hyrat vetanake janë të planifikuara 1,158,214.00 euro ose 7.56 % që në total i bije të kemi një buxhet të vlerësuar për vitin 2027 është 15,329,208.00 euro.

Ashtu siç e parashohin edhe rregullat mbi diskutimet publike, Korniza ka qenë në diskutim publik, pjesëmarrja ka qenë jo e dëshiruar, pjesëmarrja ka qenë e mirë që të ipen edhe rekomandime apo kërkesa që të futen në buxhetin e vitit 2027 edhe pse diskutimet publike priten që të fillojnë së shpejti me qytetar. Si rezultat buxheti për vitin 2027-2029 i vlerësuar në Kategoritë Ekonomike është si vijon:

Paga dhe mëditje janë 10,368,538,35 euro ose 67.64 %

Mallra dhe shërbime 2,225,875.00 ose 14.19 % në raport me buxhetin e tërësishëm

Shpenzime komunale janë 299,002,65 ose 1.95 %

Subvensionet janë 735,000.00 ose 4.79 % si dhe

Investime Kapitale 1,700,792.00 ose 11.42 %

Unë nuk po shtoj më tepër duke pasur në konsideratë kohën tuaj, por ju për çdo rast mund të bëni pyetje, ne jemi këtu e kemi dokumentin dhe mund të ofrojmë sqarime. Kur ti kalon hapat ligjor mund ta marim qarkoren e dytë buxhetore ku përcaktohen limitet e kategorive ekonomike në verzionin përfundimtar sipas Ministrisë së Financave, ju faleminderit për vëmendje!

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, A keni pyetje apo diskutime ?

Kush është për miratim ?

Për: 5

Kundër: 0

Abstenim: 0

3. Të ndryshme

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal - a keni diskutime në pikën të ndryshme, a e dëshiron dikush fjalën për diskutim ? Fjala për :


Jeton Biqkaj – Anëtar i KPF-së, Përshëndetje Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Po e shoh të arsyeshme që të ngritët ky shqetësim dhe e shoh të nevojshme të diskutohet

Ka të bëjë me punimet që po bëhen në rrugë sidomos në rrjetin e ujësjellësit, po bëhen punimet dhe asfalti po dëmtohet dhe po mbetet i shkatërruar dhe kjo po bëhet pengesë e madhe për qarkullim , unë mendojë që çdo kontratë që bëhet rruga duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme, ka me muaj të tërë që pas punimeve rrugët mbesin në gjendje të keqe, dua ti drejtohem i ekzekutivit nga Komiteti për Politikë dhe Financa por pse jo edhe për kuvend që të na ipet një sqarim, A është kontrata e lidhur që të lihet në atë gjendje pas punimeve rrugët, apo është kontrata që pas punimeve asfaltimi të kthehet në gjendje të mëparshme.

Arbnore Beqiraj Fera -Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera në kuadër të kësaj pike, nëse jo, e konstatoj të mbyllur takimin e sotëm.

Mbledhja përfundoj në ora: 10:15

Procesmbajtëse


Violeta Krasniqi

Kryesuese e Kuvendit Komunal


Arbnore BEQIRAJ FERA





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Z A P I S N I K

Sa šeste (6.) sednice Komiteta za Politiku i Finansije održanoj: 22.06.2026

Sednica održana i opštinskom objektu i počela u 10:05 časova. Na sednici osim članova KPF-e, prisutni su bili: stručna skupštinska služba, ostali opštinski službenici i predstavnik OEBS-a itd. Sednicu otvorila i predsedavala Predsedavajuća Komiteta za Politiku i Finansije Arbnore Beqiraj Fera koja za sednicu predložila ovaj,

Dnevni red

1. Razmatranje i usvajanje Zapisnika sa prošle sednice Komiteta za Politiku i Finansije.
2. Predlog odluke za usvajanje Srednjoročnog Okvira Budžeta (SOB) Opštine Kamenica za period 2027-2029.
3. Razno.

Arbnore Beqiraj Fera -Predsedavajuća Skupštine Opštine poštovani članovi KPF-e, Dobrodošli na šestoj redovnoj sednici KPF-e za ovu godinu. Konstatujem da imamo dovoljan kvorum za održavanje ove sednice, dnevni red i materijal ste dobili na vreme. Ima li predloga po ovoj tački?

Arbnore Beqiraj Fera -Predsedavajuća Skupštine Opštine, pošto nema predloga, stavljam na glasanje dnevni red,

Ko je za usvajanje dnevnog reda ?

Za, 4

Protiv i uzdržanih nema.

1. Razmatranje i usvajanje Zapisnika sa prošle sednice Komiteta za Politiku i Finansije

Arbnore Beqiraj Fera -Predsedavajuća Skupštine Opštine – nalazimo se kod prve tačke dnevnog reda, Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prošle sednice KPF-e, ima li primedbe ili diskusije po ovoj tački ?

Ko je za usvajanje ove tačke?

Ze: 5

Protiv: 0

Uzdržano: 0

2. Predlog odluke za usvajanje Srednjoročnog Okvira Budžeta (SOB) Opštine Kamenica za period 2027-2029

Arbnore Beqiraj Fera -Predsedavajuća Skupštine Opštine, druga tačka dnevnog reda je Predlog odluke za usvajanje Srednjoročnog Okvira Budžeta (SOB) za Opštinu Kamenica za period 2027-2029, po ovoj tački reč ima

Selami Zylfiu – Službenik iz Odeljenja za Budžet i Finansije Pozdrav Predsedavajuća, pozdrav svima. Opština Kamenica pripremala Srednjoročni Okvir Budžeta 2027-2029, neću vam oduzeti mnogo vremena, samo jedno kratko izlaganje kao obaveštenje kojim pravcem se Opština Kamenica orijentisala. Ovaj okvir je pripremljen po Srednjoročnom Okviru 01 / 2027 i po osnovi državne formule prema poslednjem popisu stanovništva, Opština Kamenica ima 22.868 stanovnika na osnovu državne formule koja se sastoji od određenih ograničenja što daje rezultata da imamo umanjeni opštinski budžet za 275.895 evra ili 1.77 % manje nego prošle godine. Kao rezultat toga imamo smanjenje kod Obrazovnog Granta, pregled Granta posebno ukupan planirani budžet za 2027 godinu iznosi 15,329,208.00 evra i to su:

Grant Vlade je 8,769,138.00 evra ili 57.21 % Opštinskog Budžeta.

Specifičan Grant Obrazovanja je 3,438,157.00 evra ili 22.43 %

Grant Zdravstva je 1,743,697.00 evra ili 11.37% i

Rezidencijalne Usluge koji se računa kao zaštićen grant, iznosi 220,000.00 evra ili 1.44% Sopstveni prihodi su planirani u iznosu od 1,158,214.00 evra ili 7.56 % što ukupno se javlja da imamo procenjeni budžet za 2027 godinu i je 15,329,208.00 evra.

Onako kako predviđaju propisi prema javnoj raspravi, Okvir budžeta bio na javnoj raspravi, učešće bilo nezadovoljavajuća da bi se uputile preporuke ili zahtevi da se stave u budžet za 2027 godinu, mada javne rasprave se očekuje da počnu vrlo brzo. Kao rezultat budžeta za period 2027-2029 procenjen u Ekonomskim kategorijama je sledeći:

Plate i dnevnice su 10,368,538,35 evra ili 67.64 %

Robe i usluge 2,225,875.00 su 14.19 % u odnosu na ukupan budžet.

Kapitalni troškovi su 299,002,65 ili 1.95 %

Subvencije su 735,000.00 ili 79 % kao i

Kapitalne Investicije su 1,700,792.00 ili 11.42 %

Ja više nemam što da dodam s obzirom na vaše vreme, ali vi u svakom trenutku možete postaviti pitanje, mi smo ovde, dokument imamo i možemo da damo objašnjenja. Kada je prošao zakonske korake možemo pridobiti drugu okružnicu gde su određene granice ekonomskih kategorija u konačnoj verziji prema Ministarstvu Finansija, hvala na pažnji!

Arbnore Beqiraj Fera -Predsedavajuća Skupštine Opštine Ima li pitanja ili diskusija?

Ko je za usvajanje?

Za: 5

Protiv: 0

Uzdržano: 0

3. Razno

Arbnore Beqiraj Fera -Predsedavajuća Skupštine Opštine – ima li prijavljenih za diskusiju u tački razno, želi li neko uzeti reč ? Reč ima :

Jeton Biqkaj – Član KPF-e, Pozdrav Predsedavajuća, pozdrav svima. Vidim opravdanim što se ova zabrinutost potegla i da je neophodno o tome raspravljati.


Odnosi se radova koji se izvode na put na vodovodnoj mreži, izvode se radovi dok asfalt se oštećuje i o staje oštećen i to stvara veliku smetnju za kretanje. Mislim, svaki ugovor koji se sklapa kada sa pravi put treba se vratiti u prvobitno stanje, mesecima nakon radova izvedenim na putu ostaju u lošem stanju, hoću da se obratimo izvršnoj vlasti odavde od Komiteta za Politiku i Finasnije ali zašto ne i za skupštinu da nam se da objašnjenje. Da li je ugovor zaključen da se stavljaju u takvo stanje radovi na putu, ili ugovor je da se nakon izvedenih radova, asfalt vrati u prvobitno stanje.

Arbnore Beqiraj Fera -Predsedavajuća Skupštine Opštine, ima li drugih diskusija u okviru ove tačke, ako nema zaključujem današnju sednicu.

Sednica za vršena u: 10:15 časova

Prevod: Rexhep Ibrahim

Zapisničarka




Violeta Krasniqi

Predsedavajuća Skupštine Opštine


Arbnore BEQIRAJ FERA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13, nenit 24 dhe 58, shkronja h), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës; Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal; Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15, paragrafi 8, nënparagrafi 8.2 të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregulltë të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____, sjell këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Asfaltimi i rrugës ‘Shyt Vaku’- Degëzim”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit me Znj.Shqiponjë Pira

1. **MIRATOHET** Propozim-Vendimi për buxhetimin nga bashkëfinancimi dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Asfaltimi i rrugës ‘Shyt Vaku’- Degëzim”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit me Znj.Shqiponjë Pira.
2. Në kuadër të projektit të lartëcekur, Komuna e Kamenicës dhe Znj.Shqiponjë Pira do të participojnë me kontribut financiar në shumën 74,257.40 € (shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë euro e dyzet centë), Komuna e Kamenicës me 51,980.18 € (pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë euro e tetëmbëdhjetë centë) dhe Znj.Shqiponjë Pira me 22,277.22 € (njëzet e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e njëzet e dy cent).
3. Shuma e mjeteve 51,980.18 € (pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë euro e tetëmbëdhjetë centë) nga Komuna e Kamenicës, sipas këtij vendimi, do të participohet nga Buxheti Komunal i Kamenicës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Financa dhe Buxhet të Komunës së Kamenicës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit bëhet zyrtar në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkryetares, Zyrës së Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe Arkivit.





Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Kancelarija Predsednika

Na osnovu člana 13, član 24 i 58, slova h), Zakona o Lokalnoj Samoupravi Republike Kosovo; Br. 03/L-040 Zakona o Finansijama Lokalne Vlasti Br. 03/L-049; Zakon o Upravljanju Javnim Finansijama i Odgovornosti Br. 03/L-048, izmenjen i dopunjen Zakonom Br. 03/L-221, Zakonom Br. 04/L-116, Zakonom Br. 04/L-194, Zakonom Br. 05/L-063, Zakonom Br. 05/L-007, član 15, stav 8, podstav 8.2 Zakona o Budžetskim Izdvajanjima Republike Kosovo za 2026 godinu Br. 10/L-001, člana 70, stav 70.1, slova h) Statuta Opštine Kamenica Š 02, Br. 20203 od/datum 21.06.2023, Predsednik Opštine, za redovnu sednicu Skupštine Opštine Kamenica koja će se održati dana _____, podnosi ovu:

PREDLOG ODLUKE

U vezi sa planiranjem sredstava sufinansiranja i stvaranja novog koda projekta “Asfaltiranje puta ‘Shyt Vaku’- Račvanje”, između Opštine Kamenica i učešća sa Gđo-m Shqiponjë Pira

1. **USVAJA** Predlog Odluka za planiranje sredstava od sufinansiranja i stvaranja novog koda projekta „Asfaltiranje puta“Shyt Vaku’- Račvanje”, između Opštine Kamenica i učešća Gđe Shqiponjë Pira.
2. U okviru gore pomenutog projekta, Opština Kamenica i Gđa Shqiponjë Pira učestvovaće finansijskim doprinosom u iznosu od 74,257.40 € (sedamdeset i četiri hiljada i dvesta pedeset i sedam evra i četrdeset centi), Opština Kamenica sa iznosom od 51,980.18 € (pedeset i jedna hiljada i devetsto i osamdeset evra i osamnaest centi) i Gđa Shqiponjë Pira sa 22,277.22 € (dvadeset i dve hiljade i sedamdeset i sedam evra i dvadeset i dva centa).
3. Iznos sredstava 51,980.18 € (pedeset i jedna hiljada i devetsto i osamdeset evra i osamnaest centi) Opština Kamenica, na osnovu ove odluke, učestvovaće iz Budžeta Opštine Kamenica.
4. O sprovođenju ove Odluke staraće se Predsednik Opštine u saradnji sa Odeljenjem za Finansije i Budžet Opštine Kamenica.
5. Ova odluka na snagu stupa 30 (trideset) dana nakon slanja nadzornom organu, u smislu člana 8, a u vezi sa članom 9 Zakona za Administrativno Razmatranje Akata u Opštinama, Br. 08/L-284, kao i nakon objavljivanja na oglasnoj tabli ili službenoj veb stranici Opštine

Odluka dostavljena: Kancelariji Predsednika, Kancelariji Potpredsednice, Skupštinskoj Kancelariji, Kancelariji Prevođenja, Odeljenju za Finansije i Budžet i Arhivi.

Predsednik Opštine

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 shkronja f), nenit 24 dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, si dhe nenit 70 paragrafi 70.1 shkronja h) dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, për Kuvendin e Komunës në mbledhjen e rregullt që mbahet më _____ 2026, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR CAKTIMIN E KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË KRM "HIGJIENA" DHE NË NPL "DARDANA" SH.A. NË KAMENICË

1. Me këtë Vendim caktohet kompensimi për anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA" dhe në Ndërmarrjen Publike Lokale "DARDANA" Sh.A. në Kamenicë.
2. Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA" dhe në NPL "DARDANA" Sh.A. në Kamenicë kompensohet në shumën prej 250.00 € (dyqind e pesëdhjetë euro) në muaj.
3. Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA" dhe në NPL "DARDANA" Sh.A. në Kamenicë kompensohen në shumën prej 200.00 € (dyqind euro) në muaj.
4. Kompensimi i përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij Vendimi paguhet nga buxheti i Komunës së Kamenicës.
5. Kompensimi i përcaktuar me këtë Vendim mbetet në fuqi për aq kohë sa Komuna e Kamenicës ka të emëruar anëtarë në Komisionet Komunale të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA" dhe NPL "DARDANA" Sh.A., deri në ndryshimin ose shfuqizimin e këtij Vendimi, apo deri në rregullimin e kësaj çështjeje me legjislacionin në fuqi.
6. Bashkëngjitur këtij Vendimi janë Vendimi për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA" dhe Vendimi për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL "DARDANA" Sh.A.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, pushojnë së vlefshmi të gjitha vendimet e mëparshme në pjesën që rregullojnë kompensimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA" dhe në NPL "DARDANA" Sh.A.

8. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në pajtim me nenin 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen zyrtare të Komunës.

A r s y e t i m


Kuvendi i Komunës së Kamenicës ka miratuar vendimet për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "HIGJIENA" dhe në NPL "DARDANA" Sh.A., si organe përfaqësuese të Komunës në ushtrimin e të drejtave të aksionarit në ndërmarrjet publike lokale.

Duke marrë parasysh natyrën e vazhdueshme të angazhimit të këtyre komisioneve dhe përgjegjësitë e tyre në mbikëqyrjen dhe përfaqësimin e interesit të Komunës në organet drejtuese të ndërmarrjeve publike, paraqitet nevoja për përcaktimin e një kompensimi të unifikuar dhe të rregulluar për funksionimin e tyre.

Përcaktimi i kompensimit synon të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të anëtarëve të komisioneve, si dhe funksionim efikas dhe të qëndrueshëm të mekanizmit përfaqësues të Komunës në ndërmarrjet publike lokale.

Për arsyet e cekura më lart, propozohet miratimi i këtij Vendimi.

T'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkyetares, Zyrës për Burime Njerzore, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Shërbimit Profesional të Kuvendit, Zyres për përkthime, dhe QSHQ - Arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të nenit 5, shkronja b), neneve 11, 13, 14 dhe 17, shkronjat a) dhe c), si dhe nenit 58, shkronja h), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), të nenit 6, paragrafi 1, pika 1.2, nenit 14 dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, nenit 13 dhe nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe të nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja h), nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h), dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Komunës së Kamenicës, e cila mbahet më ____ 2026, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

për pëlqim paraprak dhe inicim të procedurës së shprehjes së interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale

- JEPET PËLQIMI PARAPRAK** për inicimin e procedurës së shprehjes së interesit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, në kohëzgjatje prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjetësh, të pronës së paluajtshme komunale, për qëllime investuese me interes publik dhe zhvillimor, në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës së Kamenicës dhe legjislacionin në fuqi.
- Prona e paluajtshme komunale që është objekt i këtij vendimi ndodhet në Zonën Kadastrale Kamenicë, e evidentuar sipas Certifikatës së Pronësisë P-71107041-02071-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 13,258 m², në pronësi të Komunës së Kamenicës. Dhënia në shfrytëzim do të bëhet vetëm për pjesën e nevojshme të kësaj prone për realizimin e qëllimeve investuese me interes publik dhe zhvillimor, ndërsa pjesa tjetër e parcelës mbetet në pronësi dhe shfrytëzim të Komunës së Kamenicës.
- Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës është realizimi i qëllimeve investuese me interes publik dhe zhvillimor, në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor, me synim zhvillimin ekonomik lokal, krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e vlerës së pronës komunale dhe sigurimin e përfitimeve për Komunën e Kamenicës.
- Përzgjedhja e ofertës fituese bëhet nga komisioni përgjegjës për zhvillimin e procedurës së shprehjes së interesit, mbi bazën e ofertës ekonomikisht më të favorshme, në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara në dokumentacionin e procedurës dhe legjislacionin në fuqi.

5. Kushtet e pjesëmarrjes, kriteret e vlerësimit, dokumentacioni i nevojshëm, garancitë financiare dhe kushtet e tjera të procedurës përcaktohen në dokumentacionin e procedurës së shprehjes së interesit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
6. Realizimi i qëllimeve investuese lejohet vetëm në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor, kushtet urbanistike dhe kushtet ndërtimore të përcaktuara nga organet kompetente të Komunës së Kamenicës.
7. Dhënia në shfrytëzim nuk ndikon në të drejtën e pronësisë së Komunës së Kamenicës mbi pronën e paluajtshme, e cila mbetet pronë publike komunale gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Marrëdhënia kontraktuale ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe përfituesit të së drejtës së shfrytëzimit rregullohet me kontratën për dhënien në shfrytëzim, e cila lidhet pas vendimit të Kuvendit të Komunës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
9. Obligohen Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, dhe Diasporë, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe organet e tjera kompetente që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
10. Pas përfundimit të procedurës së vlerësimit, Komisioni i paraqet Kuvendit të Komunës raportin me rekomandim për ofertën më të favorshme. Kuvendi i Komunës, në bazë të këtij raporti, merr vendim për përzgjedhjen e përfituesit të së drejtës së shfrytëzimit dhe autorizon Kryetarin e Komunës për lidhjen e kontratës për dhënien në shfrytëzim, në përputhje me vendimin e Kuvendit dhe legjislacionin në fuqi.
11. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ – arkivit.


Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kamenicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71107041-02071-2	Parcelë / Parcela / Parcel	13258



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obradio/Created: Ramush Ismaili

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 22.06.2026

Koha/ Vreme/ Time: 03:29:33



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /
Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Kamenicës

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	03-729-2026
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	22.06.2026 - 14:42
Komuna / Opština / Municipality:	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbientri/Emri i afatizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licni broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country ofcitizenship	Diçindia/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen t	Krijnar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhurnuar Ažurirano Updated
Komuna e Kamenicës				600535390	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO		30.12.2020	

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhurnuar Ažurirano Updated
/		SKENDERBEU		





B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njesitë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kat/ Katet Br./Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i kualtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Azuritano Updated
P-71107041-02071-1	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICE	Kamenicë / Kamenica / Kamenice	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / U		QENDRA TREGTARE ZEJTARE / QENDRA TREGTARE ZEJTARE / QENDRA TREGTARE ZEJTARE	54316	Tokë Ndërtimore - Trrall - (54316 m²) / / Gradëvinsko zemljište - Zemljište - / / Construction land - Land - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dzavina / Single possessor	22.06.2026
P-71107041-02071-2	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICE	Kamenicë / Kamenica / Kamenice	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / U		QENDRA TREGTARE ZEJTARE / QENDRA TREGTARE ZEJTARE / QENDRA TREGTARE ZEJTARE	13258	Tokë Ndërtimore - Trrall - (13258 m²) / / Gradëvinsko zemljište - Zemljište - / / Construction land - Land - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dzavina / Single possessor	22.06.2026
Totali i sipërfaqes së parcelave: 67574											



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13, nenit 24 dhe 58, shkronja h), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës; Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal; Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15, paragrafi 8, nënparagrafi 8.2 të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregulltë të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____, sjell këtë:

PROPOZIM-VENDIM

Për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Asfaltimi i rrugës ‘Shyt Vaku’- Degëzim”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit me Znj.Shqiponjë Pira



1. **MIRATOHET** Propozim-Vendimi për buxhetimin nga bashkëfinancimi dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Asfaltimi i rrugës ‘Shyt Vaku’- Degëzim”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit me Znj.Shqiponjë Pira.
